

V E N D I M
Nr. 702, datë 27.12.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 402, DATË 11.6.2001, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 7703, DATË
11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË",
NDRYSHUAR ME LIGJET NR. 7392, DATË 17.5.1995, NR. 8286, DATË 16.2.1998, NR.
8392, DATË 2.9.1998, NR. 8575, DATË 8.2.2000, NR. 8776, DATË 26.4.2001 DHE NR.
7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË""**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, në paragrafin e parë të pikës 6 të kapitullit III të bëhen këto ndryshime:

- Shprehja "në masën 15 për qind të të ardhurave fikse vjetore prej 10 800 lekësh" zëvendësohet me shprehjen "në masën 3 890 lekë".

- Shprehja "9 për qind e të ardhurave fikse prej 10 800 lekësh" zëvendësohet me shprehjen "2 335 lekë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.1.2002.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta